RADIOTELEVIZIONI I KOSOVËS
RADIO TELEVIZIJA KOSOVA
RADIO TELEVISION OF KOSOVO

Komunikatë

Bordi i RTK-së mban takimin e fundit me kryesinë aktuale të Bordit

Bordi i RTK-së mbajti mbledhjen e fundit duke qenë të kryesuar nga kryetari Boletini dhe zëvendëskryetarja Berisha. Zëvendëskryetarja Arta Berisha gjatë takimit të sotëm ka dorëzuar dorëheqjen e saj nga roli i nënkryetares, para mbarimit të mandatit të saj, duke i hapur rrugë emërimit të një zëvendëskryetari të ri. Kjo me qëllim që Bordi si organi më i lartë drejtues i RTK-së të jetë funksional në kryerjen e detyrimeve karshi institucionit.

Në përputhje me dispozitat e përcaktuara në Ligjin e RTK-së, procesi zgjedhor për zëvendëskryetarin e ri u zhvillua nën udhëheqjen e kryetarit aktual. Kështu, Bordi i RTK-së tanimë do të vazhdojë punën nën udhëheqjen e nënkryetares së re, Albulena Mehmeti, e cila është zgjedhur me shumicë votash nga anëtarët e tjerë të Bordit.

Znj. Mehmeti sjell një përvojë të pasur dhe përkushtim në rolin e saj, duke treguar njohuri të misionit dhe vlerave të transmetuesit publik. E provuar në fushën e menaxhimit dhe financave, ajo është një zgjedhje e duhur për të vazhduar kontributin në suksesin e vazhdueshëm të RTK-së.

Gjatë takimit, bordi diskutoi gjerësisht edhe çështje të tjera të rëndësishme, me një fokus të veçantë në hartimin e planit të auditimit për vitin 2024 dhe formulimin e strategjisë së auditimit për tre vitet e ardhshme, bazuar në propozimet e Njësisë së Brendshme të Auditimit dhe Komitetit të Auditimit të Brendshëm. Diskutimet nënvizuan përkushtimin e bordit për të siguruar transparencën, përgjegjshmërinë dhe menaxhiminefektiv në të gjitha operacionet e RTK-së.

RTK mbetet e palëkundur në përkushtimin e saj për mbajtjen e standardeve më të larta të integritetit, profesionalizmit dhe shkëlqimit si media publike në Kosovë.